

UDHËZIM
Nr.8, datë 27.11.2007

PËR NIVELET KUFITË ZHURMAVE NË MJEDISE TË CAKTUARA

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës dhe në zbatim të pikës 2 të nenit 2 të ligjit nr.9774, datë 12.7.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”

UDHËZOJMË:

1. Nivelet kufi të zhurmës për mjedise të caktuara, të jenë sipas vlerave udhëzuese të Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH) të dhëna më poshtë në aneksin 1, bashkëngjitur këtij udhëzimi.

2. Si mjedise të caktuara, për efekt të zbatimit të këtij udhëzimi, janë identifikuar mjediset e zonave të banimit, (jashtë banesës, mjediset e brendshme të banesës), institucionet (arsimore, parashkollore e shëndetësore), zona me aktivitet social-ekonomik, mjedise urbane dhe parqet publike.

3. Ekspertët e certifikuar që bëjnë matjet e zhurmës në mjediset e përmendura në pikën 2 të këtij udhëzimi, mbajnë parasysh shpjegimet që shoqërojnë aneksin 1.

4. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I MJEDISIT, PYJEVE
DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE**
Lufter Xhuveli

MINISTRI I SHËNDETËSISË
Nard Ndoka

ANEKSI 1
NIVELET KUFITË ZHURMËS PËR MJEDISE TË CAKTUARA

Mjedisi	Efekti kritik në shëndet	LA _{eq} (dBA)	Koha bazë (orë)	LA _{max} Fast (dB)
Zona banimi				
Jashtë banese	Bezdi (shqetësim) serioze gjatë ditës dhe mbrëmjes	55	16	-
	Bezdi (shqetësim) i moderuar gjatë ditës dhe mbrëmjes	50	16	-
Në brendësi të banesave	Kuptueshmëri e bisedës dhe (bezdi) shqetësim i moderuar gjatë ditës dhe mbrëmjes	35	16	-
Në brendësi të dhomës së fjetjes	Prishja e gjumit natën	30	8	-
Jashtë dhomës së fjetjes	Prishje e gjumit, dritare e hapur (vlera nga jashtë)	45	8	-
Institucione				
Klasa mësimi, institucione-mjedise parashkollore (brenda)	Kuptueshmëri e bisedës, vështirësi në kuptimin e informacionit, komunikimin e mesazhit	35	Gjatë mësimit	-
Dhomat e fjetjes në kopshte (brenda)	Prishje e gjumit	30	Koha e gjumit	-

Oborri i shkollës, vendet e lojrave në shkollë	Bezdi (shqetësim) - (burime të jashtëme)	55	Koha e pushimit	-
Spitale, salla, dhoma (brenda)	Prishja e gjumit natën	30	8	40
	Prishja e gjumit ditën dhe në mbrëmje	30	16	
Spitale, salla trajtimi (brenda)	Ndikim në pushim, çlodhje	# 1		
Zona me aktivitetet social-ekonomik				
Zona industriale, tregtare, qarkullimi trafiku (mjedis i jashtëm dhe i brendshëm)	Dëmtim dëgjimi	70	24	110
Mjedis urban				
Mjedise publike, të jashtme apo të brendshme	Dëmtim dëgjimi	85	1	110
Ceremoni, festivale dhe argëtime	Dëmtim dëgjimi (klientët < 5 herë/ vit)	100	4	110
Muzikë nëpërmjet kufjeve të dëgjimit	Dëmtim dëgjimi	85 # 4	1	110
Tinguj – zhurme impulsive nga fishekzjarret dhe armët e zjarrit	Dëmtim dëgjimi (të rriturit)	-	-	140#2
	Dëmtim dëgjimit (fëmijët)			120#2
Parqe publike				
Parqet natyrore dhe zonat e mbrojtura	Prishje e qetësisë	#3		

Shpjegime:

$L_{Aeq} (dB_A)$ = Niveli ekuivalent i matur në shkallën A.

Koha bazë (orë) = Koha gjatë së cilës bëhet matja.

$L_{Amax} Fast (dB)$ = Niveli i matur në shkallën A në mënyrën *fast* (e shpejtë)

1 = Sa më e ulët që të jetë e mundur.

2 = Presioni zanor maksimal (L_{Amax} , fast) matur 100 mm larg veshit.

3 = Zonat e jashtme të qeta duhet të mbrohen dhe raporti i zhurmës hyrëse/shtesë me zhurmën e fonit natyral duhet të ruhet sa më i ulët që të jetë e mundur.

4 = Nën kufjet e dëgjimit, përshtatur me vlerat e fushës së lirë.